



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 10.2.2023

Nr: 49

Ora: 17:00

VENDIM

PËR

**NGRITJEN DHE THIRRJEN E MBLEDHJES SË PARË TË KOMISIONEVE TË ZONAVE TË  
ADMINISTRIMIT ZGJEDHOR, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË  
DATËS 14 MAJ 2023**

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronjat “b” dhe “n”, e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V E N D O S:

1. Ngritjen e Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor (KZAZ), për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.
2. Mbledhja e parë e KZAZ-ve do të zhvillohet në selitë e KZAZ-ve, të miratuara me vendimin nr. 41, datë 8.2.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, me njoftim paraprak për çdo KZAZ, duke filluar nga data 13.02.2023.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

**Ilirjan CELIBASHI**

Data: 10.2.2023 Nr: 49  
Ora: 17:00



“Për ngritjen dhe thirrjen e mbledhjes së parë të Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”